

HASI ENERGJI SHPK

Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

HASI ENERGJI SHPK
BILANCI
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

Nr	Shenime	Me 31 Dhjetor 2013	Me 31 Dhjetor 2012
I	AKTIVET AFATSHKURTRA	3,319,314	518,414
	1 Aktivet monetare	3,245,948	518,414
	> <i>Banka</i>	3,205,780	503,333
	> <i>Arka</i>	40,168	15,081
	2 Derivative dhe aktive te mbajtura per tregtim		
	3 Aktive te tjera financiare afatshkurtra	73,366	0
	> <i>Kliente per mallra, produkte e sherbime</i>		
	> <i>Debitore, Kreditore te tjere</i>		
	> <i>Tatim mbi fitimin</i>		
	> <i>Tvsh</i>	73,366	0
	> <i>Kerkesa te tjera</i>		
	4 Inventari	0	0
	> <i>Lendet e para</i>		
	> <i>Inventari Imet</i>		
	> <i>Prodhim ne process</i>		
	> <i>Produkte te gatshme</i>		
	5 Aktive biologjike afatshkurtra		
	6 Aktive afatshkurtra te mbajtura per rishitje		
	7 Parapagime dhe shpenzime te shtyra		
	> <i>Shpenzime te periudhave te ardhshme</i>		
	> <i>Parapagime/Garanci</i>		
II	AKTIVET AFATGJATA		
	1 Investimet financiare afatgjata		
	2 Aktive afatgjata material		
	> <i>Toka</i>		
	> <i>Ndertesa</i>		
	> <i>Makineri dhe paisje</i>		
	> <i>Aktive tjera afat gjata materiale</i>		
	3 Ativet biologjike afatgjata		
	4 Aktive afatgjata jo material		
	5 Kapitali aksioner i pa paguar		
	6 Aktive te tjera afatgjata		
	TOTALI I AKTIVEVE	3,319,314	518,414

Pasqyrat financiare jane aprovuar nga Bordi Drejtues i Hasi Energji shpk dhe jane firmosur nga:

Ylli Hahli
Administrator



HASI ENERGJI SHPK
BILANCI
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

Nr	Shenime	Me 31 Dhjetor 2013	Me 31 Dhjetor 2012
I	PASIVET AFATSHKURTRA	165,703	3,232,964
	1 Derivativet	0	
	2 Huamarjet		
	> <i>Overdraftet bankare</i>		
	> <i>Huamarrje afat shkuatra</i>		
	3 Huate dhe parapagimet	165,703	3,232,964
	> <i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>		
	> <i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>	0	144,164
	> <i>Detyrime per Sigurime Shoq.Shend.</i>		
	> <i>Detyrime tatimore per TAP-in</i>	9,148	0
	> <i>Detyrime tatimore per Tatim Fitimin</i>	155,966	0
	> <i>Detyrime tatimore per Tvsh-ne</i>	0	0
	> <i>Detyrime per Tatimin ne Burim(qera)</i>	589	0
	> <i>Te drejta e detyrime ndaj ish ortakeve</i>	0	3,000,000
	> <i>Debitore dhe Kreditore te tjere</i>	0	88,800
	4 Grantet dhe te ardhurat e shtyra		
	5 Provizionet afatshkurtra		
II	PASIVET AFATGJATA	0	500,000
	1 Huat afatgjata	0	500,000
	> <i>Hua dhe detyrime nga qeraja financiare</i>	0	500,000
	> <i>Bono te konvertueshme</i>		
	2 Huamarje te tjera afatgjata		
	3 Grantet dhe te ardhurat e shtyra		
	4 Provizionet afatgjata		
	TOTALI PASIVEVE (I+II)	165,703	3,732,964
III	KAPITALI	3,153,610	(3,214,550)
	1 Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)	0	0
	2 Kapitali aksionereve te shoq.meme (PF te kons.)	0	0
	3 Kapitali aksionar	4,600,000	100,000
	4 Primi aksionit		
	5 Njesite ose aksionet e thesarit (Negative)		
	6 Rezervat statutore		
	7 Rezervat ligjore		
	8 Rezervat e tjera		
	9 Fitimet e pa shperndara	(3,314,550)	(2,909,332)
	10 Fitimi (Humbja) e vitit financiar	1,868,160	(405,218)
	TOTALI PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)	3,319,314	518,414

Shënimet shoqëruese në faqet 08– 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Hasi Energji shpk dhe janë firmosur nga:

Ylli Halili
Administrator



REZARYA KOÇOLLARI
EKSPERIMENTAL
NR. 1/2013
NIPT: L21515021M

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E TE ARDHURAVE E SHPENZIMEVE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

Nr	Pershkrimi i Elementeve	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
1	Shitjet neto		
2	Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit	3,000,000	0
3	Ndrysh.ne invent.prod.gatshme e prodhimit ne proces	0	0
4	Materialet e konsumuara	0	0
5	Shpenzimet e personelit	(295,710)	(213,502)
	<i>Pagat e personelit</i>	(233,494)	(182,950)
	<i>Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore</i>	(62,216)	(30,552)
6	Amortizimet dhe zhvleresimet		
7	Shpenzime te tjera	(626,910)	(191,707)
8	Totali shpenzimeve (shumat 4 - 7)	(922,620)	(405,209)
9	Fitimi (humbja) nga veprimtarite e kryesore (1+2+/-3-8)	2,077,380	(405,209)
10	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara		
11	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet		
12	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare		
	121.0 <i>Te ardh.e shpenz. financ. nga inves.te tjera financ.afatgjata</i>		
	122 <i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat</i>		
	123 <i>Fitimet (Humbjet) nga kursi kembimit</i>	(8,254)	(9)
	124 <i>Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare</i>	0	0
13	Totali i te Ardhurave dhe Shpenzimeve financiare	(8,254)	(9)
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9 +/- 13)	2,069,126	(405,218)
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(200,966)	0
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14 - 15)	1,868,160	(405,218)
17	Elementet e pasqyrave te konsoliduara		

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E FLUKSIT MONETAR
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

Nr	Pasqyra e fluksit monetar - Metoda Indirekte	Me 31 Dhjetor 2013	Me 31 Dhjetor 2012
	Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytezimit		
	Fitimi para tatimit	1,868,160	(405,218)
	Rregullime per :		
	Amortizimin		
	Humbje nga kembimet valutore		
	Te ardhura nga Investimet		
	Shpenzime per interesa		
	Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	(73,366)	
	Rritje/renie ne Tepricen e inventarit		
	Rritje ne tepricen e detyrimeve	(3,022,261)	232,964
	MM te perfituara nga aktivitetet e shfrytezimit	(1,227,467)	(172,254)
	Interesi i paguar	0	
	Tatim mbi fitimin i paguar	(45,000)	
	MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit	(1,272,467)	(172,254)
	Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
	Blerja e njesise kontrolluar X minus parate e Arketuara		
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale		
	Te ardhura nga shitja e pajisjeve		
	Interesi i arketuar		
	Dividentet e arketuar		
	MM neto te perdoruara ne veprimtarite investuese		
	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare	4,000,000	500,000
	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner	4,500,000	0
	Te ardhura nga huamarrje afatgjata	0	500,000
	Pagesa e huase	(500,000)	
	Dividente te paguar		
	MM neto e perdorur ne veprimtarite Financiare	4,000,000	500,000
	Rritja/Renia neto e mjeteve monetare	2,727,533	327,746
	Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	518,414	190,668
	Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	3,245,948	518,414

Shënimet shoqëruese në faqet 08– 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

HASI ENERGJI SHPK
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONER
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

		Kapitali aksionar	Dividente	Rezerva te tjera	Rezerva stat.ligjore	Fitimi pashperndare	TOTALI
B	Pozicioni me 1 Janar 2012	100,000	0	0	0	(2,909,332)	(2,809,332)
1	Fitimi neto per periudhen kontabel					(405,218)	(405,218)
2	Dividentet e paguar						
3	Rritja rezerves kapitalit						
4	Shperndarja e fitimit						
II	Pozicioni me 31 dhjetor 2012	100,000	0	0	0	(3,314,550)	(3,214,550)
1	Fitimi neto per periudhen kontabel					1,868,160	1,868,160
2	Dividente te paguar						
3	Emetimi kapitali aksionar	4,500,000					4,500,000
4	Terheqje rezervash						
5	Shperndarja e fitimit						
III	Pozicioni me 31 dhjetor 2013	4,600,000	0	0	0	(1,446,390)	3,153,610

HASI ENERGJI SHPK
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

Informacion i përgjithshëm

“HASI ENERGJI” shpk (Shoqëria) është një shoqëri Shqiptare me aksioner kompanine ENSO HYDRO ENERGJI në datën 31 Dhjetor 2013. Shoqëria është krijuar më 03/03/2006 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 21/03/2006 me numrin e identifikimit K43522625F. Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Lagjja 18 Shtatori, pallati 41, GJIROKASTER.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë ne 31.12.2013 është Z. Ylli Halili.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte qe te zoteroje aksione ne shoqeri te tjera qe operojne ne biznesin e ndertimit dhe operimit te impianteve hidro energjitike per prodhimin e energjise si dhe te ushtroje veprimtarine e saj ne biznesin e prodhimit dhe tregtimit te energjise.

Veç kesaj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, shoqeria mund te kryeje çdo veprimtari qe rezulton ose qe lidhet ne menyre te drejtperdrejte ose jo te drejtperdrejte me objektivin e mesiperm.Per te arritur qellimin e mesiperm, shoqeria mund te kryej çdo transaksion si :tregtar, financiar, qiraje ose veprim hipotekues, i cili mund te konsiderohet i dobishem ose i nevojshem per te ndjekur objektivin e shoqerise.

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

Pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228 datë 29 prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe në përputhje me Standardet Shqiptare të Kontabilitetit. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK Shqiptar (“LEK”) që është monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

a) Të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe në përputhje me Standardet Shqiptare të Kontabilitetit. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK Shqiptar (“LEK”) që është monedha raportuese e Shoqërisë.

b) Të ardhurat

Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri, të ardhurat e lidhura me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- (i) shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- (ii) arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- (iii) volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- (iv) shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat gjenerohen nga shërbimet e ofruara klientëve bazuar në kontratë dhe njihen sipas sasisë së orëve të punës së agjentëve dhe çmimeve për njësi.

HASI ENERGJI SHPK
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

c) Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Të ardhurat dhe humbjet nga kurset e këmbimit, që vijnë për shkak të shlyerjeve të këtyre transaksioneve dhe të rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të periudhës, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare (LEK kundrejt monedhës përkatëse) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë:

	Me 31 dhjetor 2013	Me 31 dhjetor 2012
United States Dollar (USD)	101.86	105.85
European Union Currency unit (EUR)	140.2	139.59

d) Aktivet afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Kosto përfshin shpenzimet e lidhura direkt me blerjen e aktivitet. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendndodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

ii. Kostot në vijim

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas legjislacionit shqiptar duke përdorur metodën lineare të amortizimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit që do të zbatoheshin sipas kategorive të aktiveve kryesore janë si më poshtë:

Kategoritë e Aktiveve	2013	2012
Pajisje zyre-mobilje	20%	20%
Pajisje zyre- kompjuter	25%	25%
Përmirësime të ambjentëve të marra me qira	5%	5%

HASI ENERGJI SHPK
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

e) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin aktual është bazuar në shumën e tatimit të pritshëm për t'u paguar llogaritur sipas legjislacionit Shqiptar si dhe përcaktimeve në rregullat bazë kontabël në Shqipëri duke përdorur normën e tatimit të zbatueshëm në datën e hartimit të pasqyrave si dhe çdo rregullim për tatim fitimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Përqindja e tatim fitimit në fuqi gjatë vitit 2013 ishte 10% (2012: 10%).

f) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten me vlerën neto të realizueshme, që është kosto minus provigjionin për llogaritë e dyshimta.

g) Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investimet afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi deri në tre muaj, që janë lehtësisht të konvertueshme në një shumë të njohur mjeteshe monetare dhe nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë.

h) Furnitorë dhe detyrime të tjera

Furnitorët dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto.

i) Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

4. MJETE MONETARE

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Arka		
Në LEK	40,140	15,081
Në EUR	28	
Totali Arka	40,168	15,081
Banka		
Në LEK	3,068,422	500,000
Në EUR	137,358	3,333
Totali Banka	3,205,780	503,333
Totali	3,245,948	518,414

HASI ENERGJI SHPK
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

5. DETYRIME TË TJERA

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Te pagueshme ndaj punonjesve	0	144,164
Detyrime tatimore per TAP-in	9,148	0
Detyrime tatimore per Tatim Fitimin	155,966	0
Detyrime tatimore per Tatimin ne Burim (qera)	589	0
Te drejta e detyrime ndaj ish oraket	0	3,000,000
Debitore dhe Kreditore te tjere	0	88,800
Totali	165,703	3,232,964

6. HUAMARRJE

Huaja e marra nga Enso Hydro Energji shpk gjate vitit 2012 per kryerjen e shpenzimeve ne lidhje me aktivetin e kompanise, eshte paguar gjate vitit 2013.

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Hua nga Enso Hydro Energji shpk	0	500,000
Totali	0	500,000

7. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i nenshkruar me 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Kapitali i nenshkruar	4,600,000	100,000
Totali	4,600,000	100,000

Me 31 Dhjetor 2013 kapitali i nenshkruar perbehej nga 4,600 aksione me vlere nominale 1,000 Lek secili.

HASI ENERGJI SHPK
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

8. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013 dhe 2012 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Pagat e personelit	(233,494)	(182,950)
Shpenzimet per sig.shoq.shend.	(62,216)	(30,552)
Totali	(295,710)	(213,502)

9. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzime te tjera per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane ne vleren 626,910 Leke (2012: 191,707).

10. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin eshte i pagueshem ne normen 10% bazuar mbi fitimin neto per periudhen dhe korrigjuar per efekte tatimore ne perputhje me legjislacionin Shqiptar tatimor:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Fitimi para tatimit	2,069,126	(405,218)
Shtuar: Shpenzime te panjohura		
Shpenzime pa dokumentacion mbeshtetes sipas formatit te aprovuar nga autoritetet fiskale	158,098	187,657
Fitimi (humbja) i tatueshem	2,227,224	(217,561)
Humbje te mbartura nga periudha paraardhese	(217,561)	
Fitimi (humbja) neto i tatueshem	2,009,663	(217,561)
Tatim fitimi i llogaritur 10%	200,966	
Tatim fitimi i parapaguar gjate vitit	45,000	
Tatim fitimi per t'u (arketuar)/paguar	155,966	

Ne kategorine "Shpenzime pa dokumentacion mbeshtetes sipas formatit te aprovuar nga autoritetet fiskale" perfshihen te gjithe ato shpenzime te pambeshtetura ne dokumente qe nuk jane ne standartet e aprovuara nga autoritetet tatimore. Keto lloj shpenzimesh jane efektivisht kosto, por te pazbritshme per qellime tatimore.

HASI ENERGJI SHPK
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

11. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve, ose detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse vendoset apo jo një çmim. Një palë e lidhur është një palë, e cila kontrollon, kontrollohet, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë tregtare; ka një interes mbi njësinë që i jep një influencë të rëndësishme mbi entitetin; ose ka një kontroll të lidhur mbi entitetin; është ortak në shoqëri; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është sipërmarrës; ose është një anëtar i personelit drejtues të entitetit, ose mëmës së tij (duke përfshirë familjarët e afërm të çdonjërit prej individëve të sipërpërmendur).

Gjatë vitit 2013 dhe 2012 Shoqëria ka marrëdhënie me palët e lidhura si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Bilanci Kontabel		
Të arkëtueshme nga ortaket	<u>0</u>	<u>0</u>
Totali i të arkëtueshmeve nga palët e lidhura	<u>0</u>	<u>0</u>
Të pagueshme ndaj ish ortakeve	0	3,000,000
Hua afatgjate ndaj Enso Hydro Energji	<u>0</u>	<u>500,000</u>
Totali	<u><u>0</u></u>	<u><u>3,500,000</u></u>

12. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk kanë ndodhur ngjarje pas datës së bilancit të cilat mund të kërkojnë paraqitje, apo rregullim në pasqyrat financiare.

13. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

Shoqëria nuk ka angazhime dhe detyrime të mundshme që kërkojnë paraqitje në pasqyrat financiare.

14. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

a) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e instrumentave financiare do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe nga rreziku që maturimi i aktiveve që mbartin interes ndryshon nga maturimi i detyrimeve që mbartin interes, të përdorura për të financuar këto aktive. Periudha e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar mbi një instrument financiar, tregon se cili do të jetë ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të normës së interesit. Shoqëria nuk ka aktive financiare që mbartin interes në fund të vitit 2013 dhe 2012.

HASI ENERGJI SHPK
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2013 DHE 31 DHJETOR 2012

b) Rreziku i kreditit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit nëpërmjet aktiveve të saj financiare (llogaritë rrjedhëse), parapagimeve dhe llogarive të arkëtueshme. Shoqëria manaxhon rregullisht ekspozimin e saj ndaj rrezikut duke monitoruar nga afër ekspozimin ndaj palëve të treta për parapagimet dhe për llogaritë e arkëtueshme. Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 shoqëria nuk është shumë e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit.

c) Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Vlerat e mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare në pasqyrat financiare përfaqësojnë vlerën e tyre të drejtë.

d) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit pasi transaksionet ndodhin në të dyja monedhat, si ajo vendase dhe ajo e huaj. Manaxhimi monitoron dhe vendos limitin për ekspozimin e lejuar për çdo monedhë dhe në total. Shoqëria nuk angazhohet në kryerjen e veprimeve, apo tregtimin e instrumentave derivative. Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 shoqëria nuk është shumë e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

e) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku nga mospërputhja e maturiteteve të aktiveve dhe detyrimeve. Shoqëria monitoron likuiditetin mbi baza periodike në mënyrë që të manaxhojë detyrimet kur ato lindin.